



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr.5904 prot.

Tiranë. 18.2.2025

- Lënda:** Bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen me objekt: Ankim kundër vendimit nr.730, datë 10.1.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Valentin Preçi
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C pika 2, neni F pika 2, e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë :** Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha kërkimet dhe prapsimet e palëve, si dhe provat e administruara në kuadër të këtij gjykimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 3.5.2024, parashtrimeve të datës 21.1.2025 dhe në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së të datës 23.4.2024, në mënyrë të përmbledhur, vlerëson se:

I. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. *Lidhur me shkakun ankimor mbi mungesën e burimeve të ligjshme të krijimit të pasurive “Apartament banimi me sipërfaqe 84,54 m²” dhe “Garazh me sipërfaqe 14 m²”, ndodhur në ***, Tiranë.*

1.1 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, pas vlerësimit të prapësimeve dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, vlerëson se edhe në përfundim të këtij gjykimi, nuk u provuan tërësisht burimet

e ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për krijimin e pasurive “Apartament”¹ dhe “Garazh”², për sa trajtuar në vijim, në mënyrë të detajuar:

1.2 *Lidhur me të ardhurat “nga punësimi i bashkëshortes në shoqërinë “*** **”, subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, ka depozituar në cilësinë e provës aktet si më poshtë:*

1.2.1 Kopje të “*Revistës së përmuajshme rinore “***”*”³, ku rezulton se personi i lidhur znj. *** Preçi është në pozicionin e kryeredaktorit. Ky akt përbën një provë të kohës ku provohet pozicioni i punës së personit të lidhur.

1.2.2 Vendimin nr. ***, të datës **.3.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me palë paditëse, znj.*** Preçi dhe palë e paditur, Person Fizik “**** **”, me objekt detyrimin e palës së paditur, të paguajë kontributet shoqërore, kontributet shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat, të papaguara. Gjykata ka vendosur si pjesë të dispozitivit: [...] *Detyrimin e palës së paditur “**** **” të paguajë kontributet shoqërore kontributet shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat në kuadër të marrëdhënies së punës së paditëses *** Preçi, me palën e paditur “**** **”, administrator *** ** për periudhën **.5.2007 deri në **.7.2009, datën e largimit nga puna, në shumën 452.588 lekë [...]. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë **.6.2024. Vendimi i mësipërm provon marrëdhënien e punësimit të personit të lidhur znj.Preçi për periudhën **.5.2007 deri në **.7.2009.*

1.2.3 Shkresë nr. ***/* prot., datë **.1.2025 e Bashkisë Kamëz, Zyra e Gjendjes Civile, e cila konfirmon se veprimet ligjore për regjistrimin në Zyrën e Gjendjes Civile Kamëz të vajzës së subjektit të rivlerësimit e datëlindjes **.9.2009 janë kryer më datë **.12.2009 sipas aktit të lindjes të sjellë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky akt është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të provuar mungesën e dijenisë mbi mospagimin e detyrimeve nga ana e punëdhënësit për sigurimet shëndetësore/shoqërore me efekt në përfitimin e të ardhurave të barrëlindjes.

1.2.4 Në referencë të akteve të sipërcituara dhe në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit⁴, vlerësojmë se gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj u provua marrëdhënia e punësimit e personit të lidhur znj.Preçi me shoqërinë “*** **”, me efekt kjo edhe në të ardhurat nga kjo marrëdhënie punësimi. Rrjedhimisht, çmojmë të arsyeshme përfshirjen e këtyre të ardhurave në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, sipas deklarimeve në Deklaratat e Interesave Private Periodik/Vjetore (në vijim DV) për vitet 2008-2009.

1.3 *Lidhur me “mbulimin/financimin e shpenzimeve të kredisë nga vjehri *** **”, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se dhe gjatë shqyrtimit të çështjes në*

¹ Apartament banimi me sipërfaqe 84,54 m² ndodhur në ***, Tiranë.

² Garazh me sipërfaqe 14 m², ndodhur në ***, Tiranë.

³ Revista e përmuajshme rinore “****” qershor 2007; Revista e përmuajshme rinore “****” shtator 2007; Revista e përmuajshme rinore “****” nëntor 2008; Revista e përmuajshme rinore “****” janar 2009; Revista e përmuajshme rinore “****” shkurt 2009; Revista e përmuajshme rinore “****” mars 2009.

⁴ Vendimi nr. (JR) 4/2023, vendimi nr. (JR) 15/2020.

Kolegj, pretendimet e subjektit mbi mbulimin/financimin e disa shumave monetare ndër vite, nga i vjehri, për pagesat e kësteve të kredisë, (respektivisht 2.800 euro në vitin 2008, 3.200 euro për vitin 2009, 2.750 euro për vitin 2010) në total prej 8.750 euro, mbetën në nivel deklarativ, pasi nuk janë deklaruar në Deklaratat e Interesave Private Periodik/Vjetore, sikundër subjekti ka deklaruar në DV-2007 shumën 500.000 lekë si “të ardhura të realizuara nga ceremonia e martesës e bërë në nëntor 2007” apo në DV-2009 shumën 200.000 lekë si “të ardhura të krijuara nga dhuratat me rastin e lindjes së vajzës” duke specifikuar dhe dhuruesit, ndër ta dhe vjehrin *** ***, të cilat bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 përbëjnë provë në këtë proces⁵.

1.3.1 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar dhurimet/financimet nga i vjehri as në Deklaratën Vetting, e cila është dokument i hartuar nga ligjvënësi, me qëllim plotësimin nga ana e subjekteve të rivlerësimit dhe korrigjimin e pasaktësive në mënyrën e deklarimit ndër vite, përmes së cilës asetet dhe burimet e krijimit të tyre duhet të deklarohen plotësisht dhe të justifikohen ligjërisht, për më tepër që shuma e pretenduar përfituar në formë dhurimi/financimi, lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me pasuritë e paluajtshme të subjektit të rivlerësimit.

1.3.2 Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në Kolegj, pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi dhurimet/financimet nga i vjehri, mbetën të paprovuara me akte apo dokumenta ligjorë të kohës. Vlerësojmë se këto pretendime janë ngritur nga subjekti i rivlerësimit vetëm gjatë hetimit administrativ në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit, për të përmbysur pamjaftueshmërinë financiare për vitet respektive.

1.3.3 Në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit⁶, të ardhurat e pretenduara të përfituara nga i vjehri, z. *** ***, si financim/mbulim i shpenzimeve ndër vite me qëllim pagesën e kësteve të kredisë, vlerësohet se nuk duhet të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të.

1.4 Lidhur me “*rishikimin e shpenzimeve të udhëtimeve (transportit dhe qëndrimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës)*”, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, pretendimet e subjektit mbi rishikimin e kostove të udhëtimeve dhe qëndrimeve për periudhat e analizuara, përfshirë dhe shpenzimet mjekësore gjatë shtatëzanive dhe lindjes së fëmijëve në SH.B.A., mbetën në nivel deklarativ dhe të pa provuara, pasi subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, nuk ka mundur të provojë të kundërtën e shkaqeve të ankimit.

1.4.1 Në vlerësimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, lidhur me përllogaritjen e kostove të *qëndrimit tek të afërmit* dhe të njohur, standardi i përdorur nga Komisioni sipas jurisprudencës së Kolegjit, mbi përllogaritjen e një shpenzimi minimal ditor prej 5 usd/euro, nuk mund të aplikohet në rastin në fjalë, pasi nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, janë akomoduar për periudha

⁵ Referohuni vendimit të Kolegjit (JR) nr. 5/2019; vendimi (JR) nr. 19/2019 etj..

⁶ Referohuni vendimit të Kolegjit (JR) nr. 7/2023.

relativisht të gjata kohore (disa mujore)⁷ pranë të afërmeve dhe njohjeve shoqërore. Për më tepër që gjatë njërit prej këtyre qëndrimeve, përkatësisht nga data **.7.2009 deri më **.11.2009 (rreth 4 muaj) deklarohet qëndrimi pranë shoqes së bashkëshortes.

1.4.2 Subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe gjatë debatit gjyqësor të zhvilluar në Kolegj në seancën gjyqësore publike të datës 21.1.2025. I pyetur nga Vëzhguesi Ndërkombëtar i ONM-së, subjekti i rivlerësimit ka pohuar se shpenzimet e qëndrimit të bashkëshortes në vitin 2009, për një periudhë 4 mujore, janë mbuluar nga mikja e saj⁸.

1.4.3 Sa më sipër, nisur nga koha e gjatë e qëndrimit dhe marrëdhënies me akomoduesin, vlerësojmë se për rastin në fjalë, standardi i vendosur nga Kolegji në vendimin (JR) nr. 11/2019, logjikshëm nuk mund të jetë i aplikueshëm, aq më tepër kur qëndrimi i subjektit dhe personit të lidhur me të, përkon dhe me situata si shtatzani apo lindja e fëmijës, të cilat vlerësohen se shoqërohen me shpenzime ekstra.

1.4.4 Pretendimet e subjektit mbi reduktimin e kostove të qëndrimit, gjatë udhëtimeve të tyre në SHBA, janë kontradiktore me deklaratimet e tij pranë ILDKPKI⁹, deklaram në të cilin subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar si burim financimi për udhëtimet private jashtë shtetit *të ardhurat e tij dhe bashkëshortes*, duke përfshirë, jo vetëm shpenzimet e transportit, por të gjitha shpenzimet e udhëtimit (transport dhe qëndrimi). Deklarimi i subjektit, në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit, gjatë hetimit administrativ, se: [...] në procesverbalin e ILDKPKI-së ka deklaruar përballimin e shpenzimeve të udhëtimit/daljeve dhe jo shpenzimet e qëndrimit [...] vlerësohet të jetë bërë në funksion të reduktimit të kostove për efekt përlllogaritje për procesin e rivlerësimit.

1.4.5 Lidhur me shpenzimet e lindjes së fëmijëve në SHBA, referuar akteve të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk rezulton të ketë ndonjë deklaram nga subjekti, lidhur me shpenzimet mjekësore gjatë shtatëzanive dhe lindjes së fëmijëve në SHBA, shpenzime të cilat, referuar Rekomandimit të ONM-së duket se janë të konsiderueshme¹⁰.

⁷ Nga të dhënat e sistemit TIMS si dhe referuar deklaratimeve të subjektit në përgjigje të pyetësorit standard të Komisionit, ka rezultuar: (i) **.07/2008 - **.08.2008, subjekti dhe bashkëshortja kanë udhëtuar për në SHBA, dhe kanë qëndruar tek djali i hallës së bashkëshortes, shtetasi *** ***, (ii) **.07/2009-**.08.2009, udhëtim në SHBA me bashkëshorten, kanë qëndruar në banesën e shoqes së bashkëshortes *** **. Subjekti ka ndenjtur deri në datë **.08.2009, ndërsa bashkëshortja ka qëndruar atje deri në datë **.11/2009. Qëllimi ishte lindja e fëmijës, pasi bashkëshortja ishte shtatzënë; (iii) **.10/2010-**.10.2010, udhëtim në SHBA me bashkëshorten dhe vajzën. Kanë qëndruar në shtëpinë e shtetasit *** **, pa qira, subjekti rreth 2 javë, ndërsa bashkëshortja me vajzën janë kthyer më datë **.03.2011; (iv) **.10/2011- nëntor 2011, bashkëshortja dhe vajza kanë udhëtuar drejt SHBA, pasi prisnin fëmijën e dytë, për disa jave tek djali i hallës së saj.

⁸ Referohuni faqe 63 të Procesverbalit të seancës gjyqësore publike që i përket çështjes me numër regjistri (JR) 19/2024, datë 29.5.2024, për shqyrtimin e ankimit që Komisioneri Publik ka bërë kundër vendimit nr.730, datë 10.1.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ora 13:50:53 PM (referuar në vijim si “Procesverbal i seancës datë 21.1.2025”).

⁹ Procesverbali i datës 9 mars 2016 ku subjekti në përgjigje të pyetjes: “Sa shpesh keni dalë jashtë shtetit? Sa herë ka qenë për punë dhe sa herë për dalje private? Sa kanë qenë shpenzimet tuaja në udhëtimet private?”, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, është përgjigjur: [...] për qëllime private, me sa mbaj mend, kam qenë një herë në Itali me bashkëshorten, kam qenë në SHBA rreth 10-11 herë dhe, meqë bashkëshortja ka jetuar në SHBA, shpenzimet janë mbuluar nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes [...].

¹⁰ <https://polycyscout.com/health-insurance/learn/costs-childbirth-by-state>. Mesatarisht rreth 10.000 USD, në varësi nëse është një lindje normale apo një lindje me operacion cezarian.

1.4.5.1 Subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore në Kolegj të datës 21.1.2025, paraqiti dhe nga Kolegji u administrua, përgjigjia e datës ** maj 2024 nga ODM (Ohio Department of Medicaid)¹¹, si provë e re në këtë shqyrtim gjyqësor dhe deklaroi se nuk kanë patur shpenzime lindjeje dhe për këtë arsye nuk kanë deklaruar shpenzime të kësaj natyre.

1.4.5.2 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme sjell në vëmendjen e Kolegjit se në seancën gjyqësore publike të datës 21.1.2025 është paraqitur një vërejtje lidhur me përmbajtjen e dokumentit¹² të datës 8.5.2024, nënshkruar nga znj. *** *** dhe në vijim është shprehur qëndrimi se *në pamje të parë nga pikëpamja formale të gjitha provat ... plotësojnë gjithë kushtet formale për tu administruar dhe për t'ju nënshtruar vlerësimit në këtë proces*. Lidhur me këtë akt, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi¹³ se *dokumenti që kam përcjell, është i përcjellë nga zyra, që është zyra Medicaid, e cila ka konfirmuar dy lindjet e dy fëmijve të mi. Ka gjeneralitetet e personit që ka bërë dokumentin, ka të dhënat e numrit të telefonit*.

1.4.5.3 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme pas shqyrtimit të përmbajtjes së dokumentit të datës 8.5.2024 fillimisht konstaton se nuk ka të dhëna të numrit të telefonit të personit që ka bërë dokumentin apo funksionin e znj. *** *** pranë Medicaid. Të dhënat që përmban komunikimi i datës 8.5.2024, me marrës personin e lidhur znj.*** Preci me adresë: *** *** ***, **, ** *_*** dhe dërgues znj.*** **, Ohio Department of Medicaid, me lëndë “Të drejtat nga Medicaid”, referon për dy të dhëna të dala nga sistemi i përdorur për çështjen e ndihmave sipas të cilit në dy periudha kohore **.9.2009-**.9.2009 dhe **.12.2011-**.12.2011 janë të mbuluara nga *Alien Emergency Medical Assistance (AEMA) Medicaid*¹⁴. Ky komunikim nuk përmban informacion lidhur me kërkesën konkrete të bërë nga personi i lidhur znj. Preçi, nuk jep funksionin apo të dhëna kontakti për dërguesin znj. *** **, llojin e mbështetjes së dhënë apo të dhëna të tjera për të mbështetur pretendimin e subjektit të rivlerësimit. Përsa vlerësuar, këtij akti nuk duhet ti jepet vlerë prove, pasi ka të meta thelbësore në drejtim të të provuarit dhe nuk individualizohet sipas kërkesave që kërkon akti *Jurat Certificate*¹⁵.

1.4.6 Lidhur me përlllogaritjen e kostove të udhëtimit, ashtu sikurse është arsyetur më sipër në pikën 1.3 të këtyre bisedimeve, nuk provohet as pretendimi i subjektit për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit në SHBA në datat **.7.2008-**.8.2008 nga babai i bashkëshortes¹⁶. Subjekti nuk paraqiti ndonjë akt për të provuar këtë pretendim si p.sh. *pagesa biletash nga babai i bashkëshortes*, për më tepër që është një pretendim që bie

11 Shih faqe 27 e aktit “Parashtrime” të datës 16.01.2025 paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.

12 Vërejmë se dokumentacioni është vërtetim përkthimi me nr.*** rep, datë **.12.2024 i noteres ***.***. me anë të cilës vërteton përkthimin nga përkthyesja e licencuar nga Ministria e Drejtësisë ***.***. dokumentin nga gjuha angleze në gjuhën shqipe. Akti i apostiluar është nga noteri publik ***.***. dhe vërteton që citoj “instrumenti si më sipër është nënshkruar para meje më datë ** Korrik 2024 nga *** Preci (emri i nënshkruarit)”.

13 Referohuni fq.60 të aktit *Procesverbal i seancës datë 21.1.2025*.

14 <https://www.medicaid.gov/>

15 Shënim - "Jurat" nënkupton një akt noterial në të cilin plotësohen të dyja këto kushte: (1) Nënshkruesi i dokumentit të noterizuar kërkohet të bëjë betimin ose pohimin se deklarata në dokumentin e noterizuar është e vërtetë dhe e saktë; dhe (2) Nënshkruesi nënshkruan dokumentin e noterizuar në prani të një Noteri Publik.- marrë nga Notary Public Handbook e shtetit Ohio SHBA.

16 Llogaritur nga Komisioni në vlerën 1.200 usd kosto bileta udhëtimiti.

dhe në kundërshtim me deklaratimet e tij në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 9.3.2016, trajtuar më sipër.

1.4.7 Për sa më sipër, vlerësojmë se pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi “*rishikimin e shpenzimeve të udhëtimit (transporti dhe qëndrimin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës)*” përfshirë edhe shpenzimet mjekësore gjatë shtatëzhanive dhe lindjes së fëmijëve në SHBA, edhe gjatë gjykimit në Kolegj mbetën të paprovuara. Vlerësojmë se këto pretendime janë ngritur nga subjekti i rivlerësimit vetëm gjatë hetimit administrativ në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit, për të përmbysur pamjaftueshmërinë financiare për vitet respektive.

1.5 Lidhur me “*rishikimin e të ardhurave të përfituara nga bashkëshortja në SHBA*”, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, pretendimet e subjektit mbetën në nivel deklarativ dhe të pa provuara.

1.5.1 Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklarinin e këtyre të ardhurave as në deklaratat periodike vjetore dhe as në deklaratën Vetting, referuar detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9049/2003 “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publik”, i ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 4095/2016¹⁷ të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së¹⁸, duke mbetur kështu e pakonfirmuar vlera reale e këtyre të ardhurave.

1.5.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij të paraqitura në Kolegj¹⁹ dhe gjatë debatit gjyqësor²⁰ në seancën e datës 21.1.2025, i pyetur nga Vëzhguesi Ndërkombëtar, ka pretenduar që bashkëshortja e tij ka përfutur benefite nga SHBA, edhe kur nuk ka qenë prezente, përtej periudhave të qëndrimit të saj në SHBA.

1.5.3 Në kushtet e mungesës së akteve provuese mbi të ardhurat e pretenduara²¹, shoqëruar me mungesën e koherencës në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit mbi

¹⁷ Mbi “*Mënyrën e deklarinimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj, nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*”

¹⁸ Në pikën 20 të tij, specifikohet: Deklarimi si burim krijimi i të ardhurave nga pagat të shoqërohet me dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat neto nga institucioni pranë të cilit kanë qenë dhe janë të punësuar subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, që mbartin detyrimin për deklarim të pasurisë.

¹⁹ Referohuni fq. 30 e në vijim të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit paraqitur në seancën e datës 21.1.2025 Për vitin 2009 subjekti pretendon të ardhura nga asistenca sociale në vlerën 1.692 usd, përtej vlerës 846 usd konfirmuar me aktet në dosje të Komisionit, “*Assistance group eligibility history*” nga ku konstatohet se për këtë vit janë përfutur disa shuma monetare në vlerat 69 usd për periudhën 23.09.2009 - 30.9.2009; 259 usd për periudhën 1.10.2009 - 31.10.2009 dhe 259 usd për periudhën 1.11.2009 - 28.2.2010, referuar akteve inventarizuar me nr. ***/*** e vijim në dosjen e ILDKPKI. Për të njëjtat periudha konfirmohet dhe nga vetë subjekti në pyetësorin standard kur deklarohet vendqëndrim i bashkëshortes në SHBA. Për vitin 2010, sipas akteve të depozituara nga subjekti, “*Assistance group eligibility history*”, konfirmohet përfitimi i disa shumave monetare duke nisur nga periudha 7.10.2010 deri në 31.10.2010, periudhë kohore që korrespondon me arritjen e bashkëshortes dhe të bijës në SHBA, referuar të dhënave të sistemit TIMS dhe deklaratimeve të vetë subjektit në përgjigje të pyetësorit standard të Komisionit. Edhe për vitet në vijim, përfitimi i konfirmuar sipas dokumentit: “*Assistance group eligibility history*” korrespondon me të dhënat e dala nga sistemi TIMS dhe deklaratimet e subjektit në përgjigje të pyetësorit standard.

²⁰ Referohuni fq. 64 i aktit *Procesverbal i seancës datë 21.1.2025*.

²¹ Akte si: dokumente zyrtare, lëvizje të llogarive bankare, çek bankar, apo ndonjë të dhënë tjetër që të provojnë përfitimin e të ardhurave në masën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

vlerën e të ardhurave të përfituara, vlerësojmë se edhe në përfundim të këtij procesi gjyqësor, mbetën të paprovuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi përfitimin e të ardhurave vjetore për periudhën 2009-2016 në *formën e asistencës sociale*, përtej shumave të llogaritura nga Komisioni në analizën paraprake financiare, përcjellë subjektit me aktin “Rezultate të hetimit administrativ”²².

1.5.4 Për sa më sipër, vlerësohet se të ardhurat e bashkëshortes në formën e *asistencës sociale* në SHBA, duhet të llogariten në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për aq sa provohet përfitimi i tyre me dokumentacion justifikues²³, sipas periudhave të konfirmuara në këto akte.

1.6 Lidhur me rishikimin e zërit “Shpenzime qiraje”²⁴, subjekti i rivlerësimit edhe gjatë parashtrimeve të tij në Kolegj, ka pretenduar korigjimin e shpenzimeve të jetesës së familjarëve në SHBA, për “shpenzimet për qira” të llogaritura si zë më vete, pasi ato janë element përbërës të indeksit të shpenzimeve mesatare të jetesës sipas të dhënave zyrtare në SHBA.

1.7 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme i vlerëson jo bindëse këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, pasi, sikurse dhe Kolegji ka vlerësuar në jurisprudencën e tij²⁵, shpenzimet e qirasë janë llogaritur fillimisht në analizën paraprake financiare nga Komisioni, ekzaktësisht sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte, duke ndjekur të njëjtën metodologji të konsoliduar për shpenzimet e jetesës së subjekteve të rivlerësimit si në Republikën e Shqipërisë apo dhe jashtë saj, sipas së cilës, standardi i shpenzimeve të përlllogaritura nga institucionet zyrtare përkatëse pranohet si rregull në gjithë zërat e vet, si dhe faktit që shpenzimet e jetesës janë bazuar në nivelin e varfërisë sipas këtij standardi zyrtar, vlerësohet i pa mbështetur ky pretendim i subjektit të rivlerësimit. Vlerësojmë se këto pretendime janë ngritur nga subjekti i rivlerësimit në përfundim të hetimit administrativ të Komisionit, për të përmbysur pamjaftueshmërinë financiare për vitet respektive.

1.8 Duke përfunduar, për pasuritë “*Apartament banimi me sipërfaqe 84,54 m²*” dhe “*Garazh me sipërfaqe 14 m²*”, ndodhur në ***, Tiranë, për sa më sipër argumentuar, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, nuk arriti të provojë mbulimin me burime të ligjshme të pasurive të mësipërme. Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, i lidhur me nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

²² Komisioni në analizën paraprake ka përlllogaritur të ardhurat nga asistenca e bashkëshortes në SHBA në vlerën 9.681 usd për periudhën 2009-2016, subjekti në prapësimet e tij depozituar në Kolegj (fq.33) pretendon të ardhura nga asistenca sociale në shumën 21.211 usd, ndërkohë në deklaratën Vetting është deklaruar përfitimi i vlerës 20.083 usd.

²³ Referuar akteve të titulluara: “*Assistance group eligibility history*” akte të cilat referojnë bashkëshorten e subjektit si përfituese dhe përcaktojnë dhe periudhat e përfitimit.

²⁴ Deklaruar nga subjekti për vitin 638 usd për 2 muaj të vitit 2011, 638 usd për 4 muaj të vitit 2012 dhe 500 usd për 8 muaj të vitit 2012 dhe 500 usd për vitin 2013 në total në shumën rreth 1.450.000 lekë konvertuar sipas kursit zyrtar vjetor.

²⁵ Referohuni jurisprudencës së Kolegjit në vendimin (JR) nr. 8/2023.

2. Lidhur me shkakun ankimor mbi mungesën e burimeve të ligjshme dhe analizën financiare të shpenzimeve dhe kursimeve në cash ndër vite, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, pas vlerësimit të prapësimeve dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkaqeve të ankimit si më poshtë:

2.1 Lidhur me “të ardhurat e deklaruara të përfituara nga lotot sportive”, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, shpjegimet e subjektit në parashtrimet e tij të depozituara më datë 16.1.2025, si dhe pohimet e tij në seancën gjyqësore të datës 21.1.2025 në Kolegj, mbeten në nivel deklarativ.

2.1.1 Nga verifikimi i akteve në dosje, rezulton se akti i vetëm, i depozituar nga subjekti për të provuar të ardhurat e pretenduara, është një shkresë “Vërtetim” i datës **.11.2010, nga kompania e bastit “*** **”²⁶, që konfirmon se *shtetasi Valentin Preçi, ka fituar pranë kompanisë “*** **” më datë **.11.2010, gjithësej shumën 7.451 euro, nga biletat (listuar vetëm katër bileta përkundrejt deklaramit të subjektit se biletat fituese kanë qenë gjithësej pesë) me numra seriale të ndryshëm.*

2.1.2 Për sa më sipër, mbështetur dhe në jurisprudencën e Kolegjit²⁷, vlerësohet se, edhe në përfundim të shqyrtimit të çështjes në Kolegj, pretendimet e subjektit mbi përfitimin e këtyre të ardhurave dhe ligjshmëria e tyre, mbeti e pa provuar dhe si të tilla, të ardhurat e pretenduara, nuk duhet të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të.

2.2 Lidhur me “kursimet e deklaruara në cash ndër vite”, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, nuk u provua e kundërta e shkaqeve të ankimit lidhur me burimet e ligjshme të kursimeve në cash të deklaruara në deklaratën Vetting, në vlerat 10.200 usd dhe 70.000 lekë.

2.2.1 Për sa trajtuar gjerësisht më sipër, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me *mbulimin/financimin e kësteve të kredisë nga i vjehri, rishikimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe qëndrimit në SHBA, të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja në SHBA, rishikimin e shpenzimeve të qirasë në SHBA dhe të ardhurave të deklaruara të përfituara nga loto sportive*, nuk arriti të provojë të kundërtën, edhe mbi pamjaftueshmëritë e konstatuara ndër vite, përfshirë këtu dhe kursimet e deklaruara në cash²⁸.

²⁶ Nga aktet në dosje ka rezultuar se vërtetimi i lëshuar nga shoqëria “*** **” është firmosur edhe nga menaxheri i sallonit, *** **, i cili, referuar përgjigjeve të subjektit në Pyetësorin nr. 2 të Komisionit, është kushëriri i bashkëshortes, nga i cili, në vitin 2016, subjekti ka blerë një automjet, sipas kontratës së datës **.10.2016.

²⁷ Referohuni vendimit (JR) nr. 8/2018, sipas së cilës, trupi gjyqësor ka arritur në përfundim se: *[...] duke qenë se biletat e lotarive sportive nuk kanë gjeneralitete, nga të cilat të mund të identifikohet fituesi, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë përkatësinë dhe ligjshmërinë e këtyre të ardhurave [...].*

²⁸ Në deklaratat periodike vjetore dorëzuar në ILDKPKI, subjekti dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar kursime cash, respektivisht: DV- 2005: “*gjendje cash në shtëpi të përfituara nga kursimet nga paga, 200.000 lekë*”; DV-

2.2.2 Sa më sipër, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit²⁹, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, për sa kohë që nuk provojnë burimet e ligjshme të krijimit të pasurive, mbulimit të shpenzimeve dhe kursimeve të deklaruara në cash ndër vite në deklaratat periodike vjetore, sipas parashikimeve dhe përcaktimeve të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, këto kursime nuk mund të shërbejnë si burim krijimi për mbulimin e shpenzimeve apo krijimin e pasurive³⁰ në vitet e mëpasshme³¹.

3. Duke përfunduar për vlerësimin e kriterit të pasurisë, çmojmë se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 3.5.2024, dhe mungesa e burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e deklaruara, e klasifikon atë në situatën e parashikuar nga neni D, pikat 3, të aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i lidhur me nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë.

II. Lidhur me vlerësimin e kriterit të figurës.

4. Lidhur me shkakun ankimor mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z.Valentin Preçi, sikundër trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 3.5.2024 dhe parashtrimet e paraqitura nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në seancën gjyqësore publike të datës 21.1.2025, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka plotësuar saktë “Deklaratën për kontrollin e figurës”, sipas Shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kontaktet me shtetasin *** ***, i cili rezulton si person i përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016.

4.1 Gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit paraqiti dokumentacion që konsistonte në një akt vdekje dhe deklarama noteriale të disa

2006: nuk deklaroi shtesa apo pakësime të kursimeve në cash; DV-2007: “shtuar gjendja cash nga të ardhurat nga paga 700.000 lekë”; DV-2008: “(i) pakësuar gjendja cash e deklaruar më parë dhe përdorur për blerje apartamenti, 1.250.000 lekë, (ii) gjendje cash në fund të vitit nga kursimet e të ardhurave familjare vjetore, 400.000 lekë”; DV-2009: “pakësuar gjendja cash gjatë vitit 2009 në shumën 400.000 lekë”; DV- 2010: “kursime nga të ardhurat familjare në cash dhe në bankë (kartë gold e b/shortes në USA) shuma rreth 3.700 USD dhe 50.000 lekë”; DV- 2011: “kursyer nga të ardhurat familjare në Cash gjatë vitit 2011 në shumën 2.000 USD”; DV- 2012: “gjendje likuiditetet në Lek të kursyera për vitin 2012 në shumën 200.000 lekë (në pjesë 100%); gjendja cash në shtëpi nga kursimet e familjes në SHBA, shuma 6.000 USD”; DV- 2013:“(i) gjendje likuiditetet në Lek të kursyera për vitin 2013 në shumën 250.000 lekë (në pjesë 100%); (ii) gjendja cash në shtëpi nga kursimet e familjes në SHBA për vitin 2013, shuma 11.000 USD”; DV - 2014, subjekti nuk ka deklaruar shtesa/pakësim/ gjendje likuiditete në cash në banesë; DV - 2015: “pakësuar gjendja cash në shumën 400.000 lekë”; DV - 2016: “(i) blerë nga b/shortja në SHBA, New York automjetin Volkswagen Jetta në datë **.10.2016 në shumën 3.250 USD, me të ardhurat cash të familjes; (ii) autoveturë marka Skoda, tip Fabia me targë AA*** AM, blerë me kontratë datë **.10.2016, në vlerë 3.200 USD, burimi kursimet cash të familjes; (iii) pakësuar gjendja cash e deklaruar më parë në shumën 130.000 lekë; (iv) pakësuar gjendja cash e deklaruar në vlerë 12.500 USD”

²⁹ Referohuni arsytimit mbi kursimet cash në vendimin (JR) nr.18/2022 vendimit (JR) nr. 26/2022.

³⁰ Nga analiza financiare, bazuar dhe në trajtimin e zërave të analizuar përgjatë ankimit, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon tërësisht shpenzimet dhe kursimet në cash të deklaruara për vitet 2007 (rishikuar shpenzimet e jetesës sipas INSTAT) deri në vitin 2013 dhe për vitet 2015-2016.

³¹ Gjithashtu, analiza financiare e paraqitur nga subjekti në parashtrimet e tij në Kolegj, referon rezultat financiar rreth – 342.000 lekë, të ndryshëm nga analiza financiare e depozituar nga subjekti në Komision në funksion të rapërtimeve ndaj rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit, në vlerën rreth – 740.000 lekë.

shtetasve³² për të provuar rastësinë e dy takimeve me shtetasit *** *** dhe *** ***, si dhe përgjigjet e marra nga organe shtetërore³³ për të treguar se *as shteti me mekanizmat e vet kombëtar dhe ndërkombëtar nuk dispononte asnjë të dhënë apo indicie për përfshirje të deputetit *** *** në krim e aq më tepër në krimin e organizuar.*

4.2 Gjatë debatit gjyqësor të zhvilluar në Kolegj në seancën gjyqësore publike të datës 21.1.2025, në përgjigje³⁴ të disa pyetjeve të drejtuara nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe Vëzhguesi Ndërkombëtar i ONM-së, subjekti i rivlerësimit u përgjigj lidhur me rrethanat e parashtruara edhe në ankimin e datës 3.5.2024, të cilat lidheshin me udhëtimet jashtë territorit të Shqipërisë me shtetasit *** *** dhe *** ***, njohjes me personat shoqërues udhëtarë në të njëjtin automjet, momentin e njohurisë së tij për qënien vëllezër të këtyre shtetasve, momentin e dijenisë për veprimtarinë kriminale të vëllezërve ***, dhe dijeninë që shtetasi *** *** ishte ortak i shoqërisë “**** **” sh.p.k., si dhe nëse ka qenë ndonjëherë humbës në lojrat e fatit dhe nëse i ka deklaruar si shpenzime, dhe marrëdhëniet familjare me shtetasin *** *** që shfaqet me funksionin *menaxher salloni* në shoqërinë “**** ****” sh.p.k.

4.3 Subjekti i rivlerësimit lidhur me historinë kriminale të shtetasit *** *** ka deklaruar³⁵ [...] *për *** *** e kam mësuar në janar të vitit 2013 për shkak të ngjarjes sepse ishte e bujshme ... aty e kam kuptuar se është pikërisht personi me të cilin unë kisha kaluar disa kohë më parë. Dhe aty kam vendosur që me atë dhe me çdokënd të afërm të tij të mos kem më asnjë lloj kontakti, qoftë edhe të rastësishëm [...] dhe i pyetur nga Vëzhguesi Ndërkombëtar kur i mësuat ato për *** ***, subjekti i rivlerësimit deklaroi³⁶ se [...] *fiks nuk di ta them janar apo shkurt... por unë për *** *** u interesova dhe nëpërmjet policisë gjyqësore për të kuptuar se kush është, çfarë përfaqëson ku jetojnë, me çfarë merren ... dhe kam marrë informacione dhe nga policia gjyqësore, po fiks fiks për të thënë sot me saktësi se çfarë informacioni ma bëri lidhjen me dy vëllezërit nuk e mbaj mend. Por di që ka ndodhur në 2013.[...].**

4.4 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vëren se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, mbeti e pandryshuar situata faktike lidhur me: (i) episodet e udhëtimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të cilat nuk mund të kualifikohen se ishin takime të rastësishme, me njerëz krejtësisht të panjohur, referuar personave me të cilët ka udhëtuar, orës së udhëtimit (*ora e daljes nga territori shqiptar dhe ajo e hyrjes*), si dhe personave të tjerë shoqërues në udhëtim; (ii) hetimet penale apo vendimet gjyqësore penale, të pasqyruara gjerësisht publikisht dhe shpeshherë pas vitit 2013, të dy shtetasve

³² Certifikatë vdekje (nga akti) për të ndjerin *** *** me vulë elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol, datë *.1.2025 me deklaruese znj. *** ***; Deklaratë noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë *.1.2025 me deklaruese znj. *** ***; Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol, datë *.12.2024 me deklarues z. *** ***.

³³ Shkresë me nr. ***/*, datë *.12.2024 e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ku i kthehet përgjigje z. Preçi duke dhënë informacione e dokumentacion lidhur me z. *** ***, Shkresë me nr. ***/* prot. *** ***, datë *.1.2025 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku i kthehet përgjigje z. Preçi duke i vënë në dispozicion materiali i kërkuar dhe disponuar në fashikullin gjyqësor (fotokopje) me numër ** procedimi i regjistruar më datë *.03.2015 pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë;

³⁴ Referohuni fq.61-73 të aktit *Procesverbal i seancës datë 21.1.2025.*

³⁵ Referohuni fq.72 të aktit *Procesverbal i seancës datë 21.1.2025.*

³⁶ Referohuni fq.72-73 të aktit *Procesverbal i seancës datë 21.1.2025.*

*** ** dhe *** ** të cilët kanë qenë subjekte të hetimeve penale dhe dënimeve në zbatim të vendimeve gjyqësore për kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të lartë³⁷; (iii) gjetjen që lidhet me kontekstin e historikut të marrëdhënieve me shtetasin *** ** si ortak në kompaninë e basteve, nga e cila subjekti i rivlerësimit kishte marrë një vërtetim konfirmimi, ku thuhet se kishte fituar 7.451 euro në vitin 2010 që përforcon dyshimin mbi vërtetësinë e rastësisë së kontakteve të evidentuara midis subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit *** **.

4.5 Sa më sipër, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në zbatim të dispozitës kushtetuese, nenit DH, “Kontrolli i figurës”, pika 2, duhet të plotësonte dhe dorëzonte një deklaratë të detajuar për kontrollin e figurës, që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklaramit sipas ligjit³⁸. Në Deklaratën e kontrollit të figurës, pjesa 5, “Të dhëna për sigurinë”, pyetja në germën “c”, kërkon nga subjekti i rivlerësimit që të deklaronte nëse ka pasur kontakt të papërshtatshëm me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës, duke plotësuar me përgjigjen *po* ose *jo*, nëse *po* duhet të jepen të dhënat e identitetit të personit, lidhjen me të dhe të dhënat për veprat penale për të cilat është hetuar ose/dhe akuzuar. Deklarimi nga subjekti i rivlerësimit do t’iu mundësonte autoriteteve verifikuese, fillimisht, kryerjen e hetimeve përkatëse dhe arritjen në përfundimin përkatës, në harmoni me rrethanat e faktit, nëse ekzistonte apo jo kontakti i papërshtatshëm.

4.6 Gjithashtu, edhe gjetja e lidhur me shoqërinë “**** **” sh.p.k. duhet çmuar si rrethanë që lidhet me etikën e magjistratit, në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas parashikimit në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

4.7 Përveç sa më sipër, Kolegji i Posaçëm i Apelit, në seancën gjyqësore të datës 13.2.2025 vendosi të pranojë në cilësinë e provës *Gjetjen e datës 4.2.2025*³⁹ e paraqitur prej vëzhguesit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe dokumentacionin shoqërues të saj. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme paraqiti qëndrimin e tij, lidhur me këtë gjetje në seancën gjyqësore të datës 13.2.2025, dhe vlerëson se analiza e të dhënave të dala nga përmbajtja e saj, mbështesin përfundimet e paraqitura në Gjetje për rrethana fakti, si më poshtë vijon:

4.7.1 Subjekti i rivlerësimit, z. Preçi në Deklaratën Vetting dhe Deklaratat e Interesave Private Periodik/Vjetor për vitet 2008 deri 2017 ka deklaruar si telefon privat e celular numrin ***. Ky deklarim, në kuptim të parashikimit të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr.84/2016, mund të përdoret si provë nga Kolegji.

³⁷ Shtetasi *** ** i hetuar dhe dënuar për krimin e vrasjes. Shtetasi *** **, i hetuar, akuzuar dhe dënuar për krimet e parashikuara nga nenet 287/2/b/3, 257/a/2, dhe 199/a/3 të Kodit Penal, referuar vendimit penal të Gjykatës e Rrethit Gjyqësor, Tiranë nr.***, datë **/4.2017, dhe vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. **-2017-***, datë **/12.2017.

³⁸ Deklarata për kontrollin e figurës plotësohet sipas Shtojcës 3, bashkëngjitur ligjit nr. 84/2016, me afat të dorëzimit dhe dërgimit pranë Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e ligjit, sipas përlogaritjes me datë fundore të periudhës, datën 31 janar 2017.

³⁹ Regjistruar në Kolegji, me nr.85/18 datë 4.2.2025.

4.7.2 Referuar vendimeve penale gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë të datës **.4.2015, Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë të datës **.6.2015, dhe Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të datës **.6.2017, rezulton se shtetasi *** ** është deklaruar fajtor për veprën penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, parashikuar nga neni 79, gërma “c” i Kodit Penal, është deklaruar fajtor për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe është dënuar me burg të përjetshëm. Referuar vendimit me nr.**, datë **.4.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, rezulton se shtetasi *** ** ka patur numrin *** (fq.15, 17 e vendimit).

4.7.3 Në aktin procesverbal “Për deklarime nga personi që tregon rrethana të dobishme për hetimin” i datës **.6.2012, i oficerit të policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Tiranë janë fiksuar të dhëna përmbledhëse nga shtetasi *** **, me gjeneralitetet respektive dhe numër celulari ***.

4.7.4 Nga përmbajtja e thirrjeve hyrëse –dalëse, për një periudhë 10 ditore, të numrit të telefonit ***, të shtetasit *** ** rezultojnë 5 episode komunikimi të shtetasit *** ** me subjektin e rivlerësimit, z. Preçi dhe konkretisht si vijon :

(i) datë **.4.2012 ora 10:33:24, shtetasi *** telefonon subjektin z. Preçi, kohëzgjatja e komunikimit është 58 sekonda;

(ii) datë **.4.2012 ora 10:56:36, shtetasi *** telefonon subjektin z. Preçi, kohëzgjatja e komunikimit është 13 sekonda;

(iii) datë **.4.2012 ora 11:47:20, shtetasi *** telefonon subjektin z. Preçi, kohëzgjatja e komunikimit është 10 sekonda;

(iv) datë **.4.2012 ora 16:58:20, subjekti i rivlerësimit, z. Preçi telefonon shtetasin ***, kohëzgjatja e komunikimit është 23 sekonda;

(v) datë **.4.2012 ora 15:14:50, subjekti i rivlerësimit, z. Preçi telefonon shtetasin ***, kohëzgjatja e komunikimit është 36 sekonda.

4.7.5 Vëzhguesi ndërkombëtar ka arritur në përfundimin se, bazuar në rrethanat e sipërcituara, provat e paraqitura së fundmi bien fort ndesh me pretendimet e z. Preçi se ai nuk kishte shoqëri me *** **. Të dhënat telefonike tregojnë se takimi në muajin qershor 2012 nuk ishte rastësor, dhe që ata kishin kontakte me njëri tjetrin të paktën që nga prilli 2012.

4.7.6 Sa më sipër, vlerësojmë se të gjitha faktet e sipërpërmendura duhet të vlerësohen si rrethana që lidhen me kontrollin e kriterit të figurës për subjektin e rivlerësimit z.Preçi dhe sjellja e tij të vlerësohet në marrjen e vendimit sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr.84/2016, si sjellje që ka krijuar vështirësi për zbulimin e së vërtetës dhe që vjen në kundërshtim me vlerat themelore të magjistratit dhe standartet e etikës dhe rregullave të sjelljes të parashikuara në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

4.8 Në përfundim, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar marrëdhënien me shtetasin *** *** në formularin për kontrollin e figurës e çon subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, parashikuar nga neni DH, pika 4 e aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit 84/2016, pasi nuk ka plotësuar saktë “Deklaratën për kontrollin e figurës” sipas Shtojcës 3 të ligjit 84/2016, lidhur me kontaktet me shtetasin *** ***, i cili rezulton si person i përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr.84/2016.

III. Lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

5. Konflikti i interesit.

5.1 Lidhur me këtë shkak ankimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se, edhe pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe rrethanat e rastit konkret mbeten të njëjta.

5.2 Në Deklaratën Vetting, rubrika “Të dhëna konfidenciale”, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “*Donacion në *** Bank për djalin e sëmurë shuma e derdhur nga *** ***, në llogari në vlerën 30.000 lekë. Lidhja me subjektin shoqërore*”. Në DV-2016, subjekti i rivlerësimit bën të njëjtin deklaram.

5.3 Procedimi penal me nr. ***, i vitit 2015, regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, “Vjedhja”, me të dëmtuar shoqërinë “**** ***” sh.p.k., me administrator shtetasin *** ***, është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, z. Preçi. Me vendimin e datës **.10.2015, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vendosur pezullim të hetimeve. Komisariati i Policisë Vorë, më datë **.3.2020,⁴⁰ ka dërguar disa dosje hetimore për parashkrim të ndjekjes penale, sipas nenit 66 të Kodit Penal, ku në numrin 2 është listuar dosje penale e pezulluar nr.***, datë **.2.2015. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, deri në çastin kur ky procedim penal i ka kaluar një prokurori tjetër, ka qenë prokurori i këtij procedimi penal.

5.4 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e datës 16.1.2025⁴¹, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *Fakti i pretenduar se vendimi i pezullimit është vendim jo përfundimtar dhe e mban të lidhur prokurorin me çështjen, është i pambështetur në ndonjë argument ligjor. Natyra e vendimit të pezullimit të hetimeve është përfundimtare pasi janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore për zbulimin e autorit/autorëve. Ndaj këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë sipas nenit 326 të K.Pr.Penale. Nuk ka asnjë parashikim procedural që e lidh prokurorin me një çështje për të cilën ka vendosur pezullimin e hetimeve [...].*

5.5 Ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, dispozita procedurale, neni 326 i Kodit të Procedurës Penale, nuk është dispozita në fuqi në momentin e vendimit të

⁴⁰ Referohuni shkresës nr. ***/*, datë **.3.2020, të Komisariatit të Policisë Vorë, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

⁴¹ Referohuni pikës 7 fq.84 të tij.

pezullimit, më datë **.10.2015. Neni 326 i Kodit të Procedurës Penale në fuqi⁴² në momentin e vendimit të marrë nga subjekti i rivlerësimit ishte formuluar në tri pika, ku në pikën 1 përcaktohen rastet të cilat prokurori vendos pezullimin e hetimeve, pika 2 kërkon që vendimi të merret pasi janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme dhe pika 3 ku përcaktohet që hetimi i pezulluar rifillon me vendim të prokurorit. Kjo dispozitë në fuqi nuk parashikonte lejimin e ankimit⁴³ në gjykatë, e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si argument për natyrën e vendimit të pezullimit të hetimit dhe shkëputjen e prokurorit nga çështja.

5.6 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se mangësitë e rezultuara në rastin konkret, lidhur me gjendjen në kushtet e ekzistencës së arsyeve të njëanësisë mbeten të pandryshuara sipas indikatorëve të përcaktuar nga pika 4 e nenit 75 të ligjit nr.96/2016, si dhe ato përsa parashtruar gjatë gjykimit në Kolegj, referenca e gabuar në përmbajtjen e nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale afekton në drejtim të nënindikatorit të parashikuar në pikën 2 të nenit 73, aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin.

6. Denoncimi i shtetasit *** **

6.1 Lidhur me këtë shkak ankimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se edhe pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe rrethanat e rastit mbetën të njëjta.

6.2 Në datën **.5.2016, mbi bazë të kallëzimit të shtetasit *** **, në ngarkim të shtetasit *** **, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, është regjistruar kallëzimi penal me numër ***, për veprën penale të “Mashtrimit”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Në përfundim të veprimeve hetimore nga ana e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, është konkluduar se fakti i mësipërm nuk përmban elemente të veprës penale, pasi kjo është një marrëdhënie juridike civile dhe si e tillë duhet të vendoset mosfillimi i procedimit penal nr. **, të vitit 2016. Kundër vendimit për mosfillimin e procedimit penal, ka bërë ankim kallëzuesi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë **.11.2016, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit *** ** dhe anulimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal për kallëzimin penal nr. ***/2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë për hetime të mëtejshme. Ndër të tjera, kjo Gjykatë ka arsyetuar se: [...] në përfundim të gjykimit, pasi shqyrtoi aktet e ndodhura në fashikullin e mosfillimit, krijon bindjen se organi i akuzës, përveç një sërë veprimesh të nevojshme që ka kryer, nuk ka thirrur me cilësinë e dëshmitarit shtetasin *** **, për të dhënë deklaratimet e nevojshme në lidhje me akuzën e ngritur nga ana e kërkuarit *** **. Gjykata konstatoi se organi i akuzës nuk ka kryer një hetim të plotë dhe, për këtë arsye, vendimi duhet të kthehet pranë organit të Prokurorisë, për hetime të mëtejshme [...]. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. **, datë **.4.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.*** akti, datë **.11.2016, të

⁴² Neni 326 “Pezullimi i hetimeve” 1.Kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm, prokurori vendos pezullimin e hetimeve. 2. Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme. 3. Hetim i pezulluar rifillon me vendim të prokurorit.

⁴³ Shënim: me ligjin nr.35/2017 këtij neni i janë shtuar pikat 4 dhe 5.

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, e cila, ndër të tjera, ka çmuar se: [...] *pyetja e shtetasit *** ** është e domosdoshme për të bërë hetimin e plotë dhe të gjithanshëm. Në rastin kur hetohet vepra penale e mashtrimit, organi i procedurës duhet të hetojë faktin se përfituesi i të hollave ka qenë në një marrëdhënie ortakërie juridiko-civile, apo e gjithë kjo ka shërbyer si gënjeshtër për realizimin e qëllimit kriminal, që synon hedhjen në dorë në mënyrë të paligjshme të pasurisë së tjetrit [...].*

6.3 Në aktin “*Parashtrime të datës 16.1.2025*”, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ngre pretendimin se kjo çështje objekt ankimi është një çështje gjyqësore e cila nuk ka përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe vlerëson se kjo çështje profesionale nuk mund t’i nënshtrohet vlerësimit nga ana e Kolegjit.

6.4 Vlerësojmë se ky pretendim është i pabazuar në jurisprudencën e Kolegjit⁴⁴, pasi akti procedural i vendimit të mosfillimit të procedimit penal në fazën e analizuar nga Komisioneri Publik nuk ka qenë në shqyrtim nga subjekti i rivlerësimit, rrethanë kjo që do të përbënte pengesë për marrjen në vlerësim, në kuptim të nenit E pika 2 e aneksit të Kushtetutës.

6.5 Ashtu sikurse ka vlerësuar dhe Gjykata e Apelit⁴⁵, kur hetohet vepra penale e mashtrimit, organi i procedurës duhet të hetonte faktin kryesor nëse përfituesi i të hollave ka qenë në një marrëdhënie ortakërie juridiko-civile, apo e gjithë kjo ka shërbyer si gënjeshtër për realizimin e qëllimit kriminal, që synon hedhjen në dorë në mënyrë të paligjshme të pasurisë së tjetrit, pretendim dhe i kallëzuesit.

6.6 Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit, me vendimin për mosfillimin e procedimit penal nr. ***/2016, nuk ka hetuar të dyshuarin kryesor, shtetasin *** ***, dhe pretendimi se kishte vështirësi pasi ndodhej jashtë Shqipërisë, në Rumani, nuk përbën një justifikim ligjor për mos hetimin e plotë të një procedimi penal, sa kohë mjetet procedurale për marrjen e deklarimeve, edhe në këto raste gjejnë rregullim të posaçëm në ligj.

6.7 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, pa kaluar në përsëritje, për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 3.5.2024, vlerëson se rrethanat e dala nga çështja konkrete, duhen vlerësuar në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, së bashku me gjetjet e tjera në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me aftësinë e përgjithshme për të marrë logjikisht hetimin, sipas pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, si dhe në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore dhe për të marrë në pyetje, sipas pikës 3 nenit 73, të po këtij ligji.

7. Denoncimi i shtetasit * **.**

7.1 Lidhur me këtë shkak ankimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se edhe pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegji, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe rrethanat e rastit mbeten të njëjta.

⁴⁴ Referohuni vendimit të Kolegjit (JR) nr.33/2021.

⁴⁵ Vendimi nr.1087, datë 23.4.2018.

7.2 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, më datë **.12.2021, me urdhër të një subjekti tjetër rivlerësimi, ka regjistruar procedimin penal me nr. ***/2021, për kryerjen e veprës penale të *“Falsifikimit të dokumenteve”*, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, me kallëzues, shtetasin *** ***, mbi bazën e akteve të dërguara për kompetencë nga ana e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Tiranë. Më datë **.10.2022, subjekti i rivlerësimit është caktuar në cilësinë e prokurorit të çështjes me short elektronik. Më datë **.11.2022, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur për gjykim para gjyqtarit të seancës paraprake të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, kërkesën penale me objekt: *“Pushimi i çështjes nr. ***, të vitit 2021, regjistruar për veprën penale ‘Falsifikimi i dokumenteve’”*, me arsyetimin se: [...] *mungojnë veprimet në kundërshtim me ligjin material penal dhe, në bazë të nenit 328/1, germa “b”, të K. Pr. Penale, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale [...].* Në vijim të kërkesës, gjyqtari i seancës paraprake, më datë **.3.2023, me vendimin nr. ***/***, ka vendosur: [...] *Pranimin e kërkesës së përfaqësuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe pushimin e procedimit penal nr. ***/2021 [...].*

7.3 Në aktin *“Parashtrime të datës 16.1.2025”*, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ngre pretendimin se denoncimi i shtetasit *** *** shtrihet tej periudhës së rivlerësimit kalimtar për komponentin profesional i cili si rregull, përfshin periudhën nga data 8.10.2013 deri më 8.10.2016, dhe si përjashtim nga rregulli, periudhën 1.1.2006 deri më 8.10.2016. Gjithashtu, edhe se mosnjohimi i kërkesës për pushim të procedimit penal nuk ka sjellë asnjë pasojë për të drejtat e shtetasit *** *** pasi ai është njoftuar rregullisht nga Gjykata e Seancës Paraprake, ka marrë pjesë në gjykim dhe ka parashtruar kërkimin e tij për kthimin e çështjes për plotësim të hetimeve.

7.4 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, lidhur me pretendimet e mësipërme, vlerëson sa vijon: (i) pika 4 e nenit 41 të ligjit nr.84/2016, është dispozita e cila bën të vlefshëm kërkimin në ankim përtej periudhës së rivlerësimit, pasi një ndër subjektet procedurale që çmon si të domosdoshëm për procesin e rivlerësimit informacione që mund të shtrihen nga 1 janari 2006 e në vazhdim është edhe vëzhguesi ndërkombëtar. Me paraqitjen e Rekomandimit të datës 23.4.2024, tri vëzhgues ndërkombëtarë kanë çmuar të domosdoshëm për vlerësim të mëtejshëm denoncimin e shtetasit *** **⁴⁶; (ii) referuar dispozitave procedurale penale, dy janë nenet ku përcaktohen përgjegjësitë e subjekteve të procedimit penal lidhur me pushimin e akuzës ose çështjes, neni 329/a ku detajohen veprimet që duhet të kryhen nga prokurori dhe neni 329/b ku jepen veprimet që kryen gjykata. Korrektësia e veprimeve procedurale të gjykatës nuk mund të shërbejë si shërim për mangësinë e veprimit të prokurorit në zbatim të pikës 4 të nenit 329/a të Kodit të Procedurës Penale.

7.5 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në analizë të sa më sipër, vlerëson se dhe ky rast duhet marrë në konsideratë nga Kolegji në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, së bashku me gjetjet e tjera në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

⁴⁶ Referohuni fq.9, germa “c” e Rekomandimit të ONM-së me nr.160/1 prot., datë 23.4.2024.

8. Në përfundim, lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në analizë të provave dhe akteve të administruara, sa vlerësuar për konfliktin e interesit dhe ato të dala nga shqyrtimi i dy denoncimeve, vlerëson se veprimet e subjektit të rivlerësimit afektojnë kriterin e aftësisë profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pika 2 dhe 3, nenin 74, pika 4 dhe nenin 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016. Sjellja e subjektit të rivlerësimit duket se vjen në kundërshti me vlerat themelore të pritshme të një magjistrati, siç është përcaktuar në nenin 3, pika 5, të ligjit nr. 96/2016⁴⁷ dhe rregullat ndërkombëtare që parashikojnë sjelljen e magjistratëve gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij, duke përfshirë parime, si: pavarësia, integriteti dhe shmangia e konflikteve të interesit, të cilat janë të domosdoshme për të mbajtur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Problematikat e konstatuara më sipër janë të vlefshme për t'u trajtuar nga Kolegji eventualisht së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, nën frymën e nenit 4, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, në kuadër të aplikimit të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, si cenim i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

IV. Kërkimi përfundimtar

9. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 3.5.2024, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, pikës 2, të nenit 4, pikës 3 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr.730, datë 10.1.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Valentin Preçi.

DREJTUESI I PROKURORISË SË POSAÇME

Altin DUMANI

⁴⁷ [...] Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbytje dhe maturi [...].